



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 2, datë 28 .02. 2013

**PËR
“VENDOSJEN E BUSTIT TË FIGURËS SË MIRËNJOHUR TË RILINDJES SONË
KOMBËTARE, JERONIM DE RADA, VEPËR E REALIZUAR NGA ODISE PASKALI”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 8/VII gërma “a”, nenit 10 pika 3/I, shkronja “ë” dhe nenit 32, gërma “m” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin për vendosjen e bustit të figurës së mirënjohur të Rilindjes sonë Kombëtare, poetit dhe luftëtarit të çështjes kombëtare shqiptare, Jeronim De Rada, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë vendosjen e bustit të figurës së mirënjohur të Rilindjes sonë Kombëtare, poetit dhe luftëtarit të çështjes kombëtare shqiptare, Jeronim De Rada, vepër e realizuar nga Odise Paskali, në lulishten përpara Parlamentit, përballë rrugës “Jeronim De Rada”, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I
Niazi KOSOVRASTI**